



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-39513

Dt. 29.03.2019

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Zekije Haxhiymeri** nga **Rahoveci** me banim në rrugën **“Halil Hamza” nr. /** në bazë të nenit 3alineja 1 pikat 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alinea 1. Pika 1.1 nenin 15 alinea 1 pika 1.1 , neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe konform nenit 14,15,16,17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 , si dhe konform nenit 4 pika 6.1 ,paragrafi 2,dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksa,tarifa,ngarkesa dhe gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.001/001-54352 dt.31.03.2016 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifatat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 27 dhe 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:	
Emri:	Zekije Haxhiymeri
Adresa:	“ Halil Hamza” nr. / Rahovec
Telefoni:	Emaili:

Emri i projektit	Objekti – Lokal afarist
Emri i projektuesit	Byroja projektuese N.P.T.”DESIGN ”.
Adresa:	



Telefoni:		Emaili:	
-----------	--	---------	--

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Zekije Haxhiymeri** i lejohet ndërtimi i objektit-**Lokal afarist** në rrugën "Remzi Ademaj" nr. Zona Kadastrale Prizren.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	ZK Prizren	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Prizren dhe është i destinuar për ndërtim të objektit –afarizem banim, etj Objekti – Lokal afarist do të ndërtohet në parcelën nr.P-71813068-02450-0 Z.K.Prizren me sipërfaqe $S=74m^2$ me dimensione sipas kopjes së planit. Sipërfaqe bruto e bodrumit është $S=67.89m^2$. Sipërfaqe bruto e përdhësës është $S=67.89m^2$. Sipërfaqja bruto e katit I është $S=67.89m^2$ Sipërfaqja bruto e katit II është $S=67.89m^2$ Sipërfaqja bruto e objektit është $S=271.56m^2$ Sipërfaqja neto e objektit është $S=224.18m^2$ Etazhiteti i objektit do të jetë B+P+2	GPS Koordinatat:

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **1137.80 €**
- Parallogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **84227.92 €**.

Lloji i ndërtimit të propozuar: Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/> Rindertim <input type="checkbox"/> Ripatim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara: Kategoria I <input checked="" type="checkbox"/> Kategoria II <input type="checkbox"/>
A përfshin kërkesa ndryshim të destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Perdorimi i propozuar i objektit – Lokal afarist

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Zekije Haxhiymeri** i lejohe ndërtimi i objektit - **Lokal afarist me etazhitet B+P+2**.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontratkuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriat i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuatë dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kprojktuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rast kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.
- Kunjëzimi i objektit, si dhe nivelizimi i themeleve të bëhet sipas kushteve ndërtimore si dhe dimensioneve të skicuara në kopjen e planit të lëshuar nga kjo Drejtori.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Zekije Haxhiymeri** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për **objektin – Lokal afarist**.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Kushte Ndërtimore
- Aktvendimi nga Drejtoria për çështje pronëso-ro-juridike mbi të drejtën e përparësisë së ndërtimit.
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Pëlqimi nga “Ekoregjon”.
- Fletëpagesa e taksave për rregullimin e tokës ndërtimore
- Tri kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Bashkëpunëtor profesional:

Xhejlane Gjini, inxhi. dip. ark.





Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor /Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : PRIZREN

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Prizren

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Površina/Area m2
P-71813068-02450-0	Parcelë / Parcela / Parcel	74,0



- Lejohet lokacioni hapësinor për ndërtimin e objektit - lokal afarist.
- Etazhiteti i objektit do të jetë B+P+2.
- Gabariti i objektit me dimensione është i shkuar në kopjen e planit.

Data: 21.02.2019

Bashkëpunëtor profesional:
Xhejlane Gjini, Inxh. dip. ark.

Shkalla/Razmera/Scale: 1:500


Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 07.11.2018

Koha/ Vreme/ Time: 09:46:15

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:

Shënim/Beleška/Note:



Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtari/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Siganture:



Republika e Kosoves

Republika Kosova-I - Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit

Opština Prizren - Prizren B Belediyesi

DREJTORIA PER URBANIZEM DHE PLANIFIKIM HAPESINOR

Numër:	04-353/01-6171
Data:	19.03.2019

KONFIRMIMI I APLIKIMIT

1. Investitori	Zekije Haxhiymeri
2. Lloji i objektit	Lokal afarist
3. Ngastra kadastrale	P-71813068-02450-0
4. Rruga ku kryhet ndertimi	"Remzi Ademaj "

Kushtet e ndërtimit	
---------------------	--

Leje të ndërtimit	
-------------------	--

LLOGARITJA			m ²	€	Totali
Siperfaqja e objektit x tarifa për metër katrorë			271.56	4.19	1137.8364
LLOGARITJA	Siperfaqja e njesive te reja banuese		Totali	Tarifa për koke banori ne €	Totali
Tarifa për rritjen e densitetit te infrastruktures	0	50	0	86.55	0
			Gjithsejt:		1137.8364

Llogaritja është bërë në bazë të Vendimit 01/011-41141 dt.10.04.2014. Llogaria është bërë në tri kopje prej të cilave një kopje investituesit, referentit për dhënjen e lejes për ndërtim dhe një kopje në shkresat e lëndës.

PËRPILUESI:

Xhejlane Gjini,ing.dipl.ark

